



SHPSH
SHKOLLA PROFESIONALE SHËRBIME

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA PROFESIONALE SHËRBIME
KORÇË

Nr 287 prot

Korçë më 23.09 2025

Lënda: Njoftim për vend të lirë

**Drejtuar : Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore
Drejtorisë së Marëdhënieve me publikun
Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive
Tiranë**

Në zbatim të Ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", I ndryshuar , të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", i ndryshuar dhe të Udhëzimit nr. 759, datë 30.9.2024 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë ,Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ,Përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve,Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe zhvillimin e vazhduar profesional të personelit" i ndryshuar,

Ofruesi publik i AFP-së, Shkolla Profesionale Shërbime, Korçë

Ju njofton krijimin e vendit të lire për pozicionin :

Mësues të teorisë dhe/ose praktikës profesionale me kohë të pjesëshme , 1 mësues ,për drejtimin "Veterinari" me ngarkesë javore 7 orë mësimore

1.Kriteret e përgjithëshme dhe kriteret e posaçme për personelin, mësues të teorisë dhe/ose praktikës profesionale në Shkollën Profesionale Shërbime, Korçë janë:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon :

- g) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- h) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- i) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- j) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- k) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- l) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit

Aplikanti duhet te plotesojë Kriteria të posaçme si vijon:

- Të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlefshme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit publik të AFP-së
- Të ketë të paktën 1 (nje) vit përvojë pune në fushën në të cilën ka kryer studimet.
- Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit , e cila permban dokumentacionin e kerkuar , sipas njoftimit te vendit te lire, duhet te perfshije :

- letër motivimi për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojces 11 te ketij udhezimi
- kartën e identitetit,
- diplomën
- librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në cv;
- certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- vërtetim të gjëndjes gjyqësore;
- vërtetim nga punëdhënësi I fundit që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi .
- të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të tyre të noterizuara të tyre.

Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

Dokumentat e aplikimit dorezohen në protokollin e ofruesit të AFP-se brenda dates.....02.10.2025

3. Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet referuar përcaktimeve të Udhëzimit nr. 759, datë 30.9.2024 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë ,Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ,Përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve,Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe zhvillimin e vazhduar profesional të personelit" i ndryshuar,.

